

NJOFTIM
Nr. 812, datë 12.2.2021

PËR APLIKIM PËR FUNKSIONIN E ANËTARIT
TË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Në mbështetje të neneve 19/2, 19/3 (pikat 1 dhe 3) e 76/3 (pika 4), të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe të pikës 6, të vendimit nr. 521, datë 20.9.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e procedurës për përzgjedhjen e kandidaturave për kryetar dhe anëtar të Komisionit të Prokurimit Publik", shpallim njoftimin për aplikim për 3 (tre) anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik.

Inkurajojmë të gjithë të interesuarit, që përmbushin kriteret, të aplikojnë.

- Aplikanti duhet të plotësojë këto kriteret:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të ketë arsim të lartë në drejtësi ose në inxhinieri, ekonomi apo ndonjë fushë të ngjashme (të paktën dy anëtarë do të përzgjidhen me arsim të lartë në drejtësi, ndërkohë një anëtar mund të përzgjidhet me diplomë në inxhinieri, ekonomi apo ndonjë fushë të ngjashme);
- ç) të ketë mbi 8 (tetë) vjet përvojë pune, nga të cilat, të paktën 3 (tre) vjet në fushën e prokurimeve;

d) të jetë person i padënuar apo ndaj të cilit nuk janë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", të ndryshuar;

dh) të mos ketë masë disiplinore në fuqi dhe të mos jetë larguar nga puna ose shërbimi civil me masë disiplinore.

- Dokumentet që duhet të dorëzohen janë, si më poshtë vijon:

- a) kërkesë për aplikim;
- b) jetëshkrim (*curriculum vitae*) i kandidatit (secila faqe, e firmosur);
- c) diplomë e arsimit të lartë (e noterizuar);
- ç) librezë pune ose dokument i ngjashëm për të vërtetuar përvojën e punës;
- d) vërtetim ose vetëdeklarim se nuk është larguar nga puna ose shërbimi civil me masë disiplinore ose që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

dh) formular të vetëdeklarimit (të plotësuar e të firmosur), në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", të ndryshuar;

e) formular të aplikimit (të plotësuar e të firmosur) për informim për zyrtarët përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta, në zbatim të ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";

ë) çdo dokument tjetër shtesë që provon përmbushjen e kriterëve të përzgjedhjes, sipas përcaktimit të pikës 11, të vendimit nr. 521, datë 20.9.2017, të Këshillit të Ministrave.

(Deklarimi i rremë sjell përjashtimin nga çdo procedurë e mëtejshme e konkurrimit dhe përgjegjësi penale, sipas legjislacionit në fuqi.)

- Vlerësimi

Komisioni *ad-hoc*, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e mbylljes së aplikimeve, bën vlerësimin paraprak të dosjeve të aplikantëve dhe publikon në web-faqen zyrtare të Kryeministrit listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret për t'u përzgjedhur.

Komisioni *ad-hoc*, brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga data e mbylljes së vlerësimit paraprak të dosjeve, bën vlerësimin me pikë të tyre, sipas parashikimit të vendimit nr. 521, datë 20.9.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e procedurës për përzgjedhjen e kandidaturave për kryetar dhe anëtar të Komisionit të Prokurimit Publik".

Pas vlerësimit të jetëshkrimit, kandidatët mund t'i nënshtrohen intervistës së strukturuar me gojë, për të cilën do të njoftohen për datat përkatëse të zhvillimit të saj.

Lista e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik, renditur sipas pikëve të marra, do të publikohet në web-faqen zyrtare të Kryeministrit.

Me qëllim vijimin e procedurave për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik, Këshilli i Ministrave dërgon në Kuvend listën e kandidatëve të kualifikuar, sipas renditjes dhe listën e kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret për t'u emëruar.

Afati i dorëzimit të aplikimit: Deri më 19 shkurt 2021.

Adresa: Kryeministria

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, 1000

Tiranë, Shqipëri

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm

Tel.: 04 22 77 401